

Kërpudhat ndërmjet kënaqësisë dhe rrezikut

June 5, 2017

131



Kërpudhat janë shumë të shëndetshme por ato mund të rrezikojnë tejmas edhe jetën e njerëzve që i konsumojnë ato, sepse jo të gjitha kërpudhat janë të hajshme. Se cilat janë llojet e kërpudhave, çfarë përbërja kanë, si mund t'i dallojmë kërpudhat e hajshme nga ato helmuese si dhe për çështje të tjera në lidhje me ta, do të mësoni më tepër nga intervista ekskluzive që portali **Albmed News** e realizoi me profesorin universitar Doc. Dr. Emri Murati.

Albmed News: Profesor çka janë në të vërtetë kërpudhat dhe cila është struktura e tyre?

Murati: Kërpudhat (Mycetes, Mycota, Fungi) janë organizma eukariote heterotrofe. Trupi i tyre është i ndërtuar nga struktura të holla fijëzore të ashtuquajtura hife të cilat të grupuara kështu sëbashku formojnë miceliumin. Kërpudhat e larta i quajmë edhe makromycetes. Si organizma heterotrofe kërpudhat nuk janë të afta që nga materiet joorganike të prodhojnë materie organike. Ata me ndihmën e sistemeve të përbëra të enzimeve të cilët i përmbajnë në trupin e tyre mund ti shfrytëzojnë materiet nga organizmat e vdekur si dhe mbeturinat nga bimët dhe shtazët e gjalla. Kërpudhat të cilat zhvillohen në organizma të vdekur dhe mbeturinat janë të ashtuquajtura si *saprofage*. Kërpudhat të cilët ekzistojnë në organizma të gjallë quhen si parazite. Ndonjëherë është shumë vështirë të vihet kufiri ndërmjet kërpudhave saprofitike dhe atyre parazite. Si parazite kërpudhat shkaktojnë smundje të ashtuquajtura **mikoza**. Makromicetet toksike janë lloje të cilat shkaktojnë helmimet me kërpudha ose **micetizme**.



Amanita muscaria (qeleshja)-helmuese



Amanita caesarea (kërpudha e Cezarit)-delikates

Albmed News: Çfarë përbërje kanë kërpudhat dhe cilat lloje mund ti gjejmë në Maqedoni?

Murati: Shumë shpesh në mesin e popullatës tonë mund të dëgjohet se kërpudhat janë mishi i pyjeve tona dhe kanë vlerë të lartë kalorike, në fakt është e njëjtë dhe barazohet me mishin. Edhe pse kërpudhat e freskëta (jo të thata) dhe kërpudhat me këmbë dhe kapelë, përbëhen nga 85-95% ujë, ata kanë vlerë të rëndësishme ushqyese. Janë bërë më shumë analiza laboratorike të kërpudhave ushqyese, veçanërisht të atyre që janë lloje ekonomiksht të rëndësishme. Sipas Bauer-Petrovska (2000), gjatë hulumtimit të gjinive të ndryshme të kërpudhave të makromiceteve në Maqedoni ekzistojnë kërpudha që përmbajnë proteine me kualitete të nevojshme për zhvillimin e njeriut. Kërpudhat rangohen në: kërpudha me kualitet të lartë ushqyes, me kualitet të mesëm dhe me kualitet të ulët të ushqyeshmerisë. Pastaj kërpudhat janë burim i mirë i disa vitaminave sic janë: tiamin, riboflavin, niacin, biotin dhe vitamin C, e në disa raste edhe beta-karotini etj. Pastaj prezenca e mineraleve: P, Na, K, është në nivel të lartë. Kurse Fe dhe Ca janë prezente në nivel të ulët. Është me rëndësi që të përmendet se kërpudhat mund të akumulojnë edhe **metale të rënda** sic janë: **Ni, Cu, Zn, Mn, Cr, Co, Se**, kurse më të rëndësishme dhe me kontaminuese janë: **As, Pb, Hg** dhe **Cd**.

Albmed News: Përveç rëndësisë ushqyese a kanë ato ndonjë rëndësi tjetër?

Murati: Kërpudhat përveç që ka rëndësi ushqyese ata përdoren edhe në farmaci dhe mjekësi si: mjet antioksidant (*Suillus luteus*, *S. granulatus* etj por ka edhe veprime fermentative, antibiotike dhe antikancerogjene (*Ganoderma lucidum* etj.).

Albmed News: A mund t'i numroni disa nga kërpudhat e ngrënëshme në viset tona?

Murati: Llojet e kërpudhave që janë të ngrënëshme mund të përmendim këto: *Agaricus campestris*, *Agaricus macrosporus*, *Amanita caesarea*, *Amanita rubescens*, *Boletus edulis*, *B. aestivalis*, *B. Regius*, *B. aereus*, *Cantharellus cibarius*, *Craterellus cornucopiae*, *Coprinus comatus*, *Lactarius deliciosus*, *Macrolepiota procera*, *Macrolepiota mastoidea*, *Marasmius oreades*, *Pleurotus ostreatus*, *Russula cyanoxantha*, *Russula virescens*, *Morchella esculenta*, llojet e tartufëve si *Tuber nigrum*, *T. aestivum*, *T. brumale* etj.



Agaricus campestris (barkuqja e livadheve)-delikates Amanita phalloides (qeleshje gjelbert)

Albmed News: Përveç kërpudhave të ngrënëshme kemi edhe helmuese, na tregoni diç për ta?

Murati: Në Maqedoni ka gjithsejt 2350 lloje të hulumtuara prej të cilëve 2050 lloje u takojnë tipit *Basidiomycota* kurse 300 atyre *Ascomycota*. Prej numrit të përgjithshëm të llojeve të hulumtuara afro 500 janë të hajshme kurse 74 janë helmuese (humanotoksike), prej të cilave afro 20 janë toksike vdekjepruese. Ndër kërpudhat e helmueshme më të rrezikshme për jetën janë ato që i perkasin gjinise **Amanita** sic janë: **Amanita phalloides** (qeleshja e gjelbërt), **Amanita virosa** (qeleshja erëkeqe), **Amanita pantherina** (qeleshja si panterkë), **Amanita muscaria** (qeleshja e kuqe), **Amanita verna** (qeleshja e bardhë), **Amanita virosa** etj. Gjinitë tjera helmuese janë: **Psilocybe**, **Inocybe**, **Clitocybe**, **Conocybe**, **Mycena**, **Hebeloma**, **Lepiota**, **Corinarius**, **Omphalotus**, **Galerina**.

Albmed News: Ku qëndron shkak dhe esenca e helmeve-toksineve të kërpudhave dhe cilat janë rreziqet e konsumimit të tyre?

Murati: Në përbërjen e këtyre kërpudhave përveç materjeve tjera kanë edhe materje helmuese-**toksine** të cilat mund të klasifikohen në disa grupe: helme faloide: falotoksin, faloin, faloidin, falocidin, falisin, dhe falin; helme orelaninë; giromitrin; muskarin; psihotrope, halucinogjene etj

Në veçanti kisha dashur që të gjithë studiuesit dhe adhuruesit e kërpudhave t`i këshilloj që të kenë një qasje mjaft serioze kur punojnë me ta, sepse edhe moskujdesi më i vogël mund tu kushtojë edhe jetën e tyre dhe më të afërmive. Gjatë mbledhjes së kërpudhave, asnjëherë nuk duhet harruar në mundësinë e zavendësimit të atyre të hajshmeve me ato helmuese. Vetëm përdorimi (konsumimi) i një kërpudhe të rritur (100 gr) e *Amanita phalloides* mund të jetë fatale, vdekjeprurëse. Qëllimi jonë nuk është që të tremben dhe të largohen studiuesit dhe adhuruesit e këtyre bukurosheve natyrore (kërpudhave) por përkundrazi që ato të kenë qasje sa më serioze duke i njohur dhe ditur sa më mirë.

Albmed News: Kjo do të thotë se popullata duhet të ketë kujdes të madh, apo jo profesor?

Murati: Po kuptohet. Mjaft serioz është paralajmërimi për ato persona të cilët mendojnë se janë njohës të mirë të kërpudhave ngrënëse dhe nga moskujdesi i tyre të pësojnë edhe ato edhe të afërmit e tyre. Dihet që

njerëzit qëmoti janë orvatur të gjejnë metoda ose mënyra për njohjen e kërpudhave të ngrënëshme dhe atyre të helmueshme. Mirëpo edhe përkundër të gjithë orvatjeve, një metode e tillë ende nuk është gjetur, por vështirë është të mendohet se dikur edhe do të gjendet. Qysh në kohën romake është menduar se helmuese janë të gjithë ata kërpudha të cilët në prerje ngjyrosen, pastaj kërpudhat që lëshojnë qumësht, pastaj ndryshimi i ngjyrës të qepa monedha e argjente gjatë zierjes i llogarisim si të helmëta. Pastaj kërpudhat të cilët rriten në drunjë, në kërcëj të rënë janë të hajshme ndërsa të gjithë ata që rriten në tokë nuk janë të ngrënëshme etj.



Amanita rubescens (kutilishte) e hajshme



Amanita pantherina (panterja)- helmuese

Albmed News: A mund t'i dallojë lexuesi dhe njohësi i rëndomtë kërpudhat e hajshme nga ato helmuese?

Murati: Vetëm lexuesi i kujdesshëm nga të gjithë këto të dhëna do të bie në përfundim se metodat e dikurshme janë të pavërteta, bile edhe shumë të rrezikshme dhe se nuk ka ndonjë metodë të „sigurtë“. Gjithashtu janë të pavërteta pohimet se të gjithë ata kërpudha të cilat janë të kafshuara nga shtazë të ndryshme si kermij, krimba, insekte, shpezë ose shtazë pylli janë të hajshme. Prandaj, edhe njëherë po përmendim se nuk ekziston asnjë metodë apo rregull (përveç atyre mikroskopike) me të cilën do të mund me siguri të dallohen kërpudhat e hajshme nga ato të helmueshme.

Albmed News: Ku mund të bëhet identifikimi ose determinimi më i saktë i kërpudhave?

Murati: Identifikimi ose determinimi më i saktë mund të bëhet vetëm nëpër laboratore mikologjike siç është ajo pranë institutit të Biologjisë në kuader të FSHMN-Shkup, i vetmi në Ballkan. Ky laborator posedon literaturë të pasur (çelsa dhe monografi) për determinimin e këtyre kërpudhave. Poashtu është e nevojshme që secila kërpudhë të njihet në detaje e pastaj të hulumtohet si dhe të kryhen analizat e duhura për ta identifikuar si: veprimi me reagjent kimik (melzer, KOH, gvajakol, H₂SO₄, që me siguri të vijmë në konstatim për cilin lloj bëhet fjalë. Për fillestarët është më se e domosdoshme që në fillim të njihen me kërpudhat helmuese vdekjeprurëse. Përveç vetive morfologjike, koha e rritjes, zhvillimit, vendi dhe substrati etj, janë me rëndësi për determinimin e tyre. Për shembull, kërpudhën *Pleurotus ostreatus*, *Fistulina hepatica*, *Armillariella mellea*, etj. asnjëherë nuk mund t'i gjejmë në tokë por në drunjë, ato të gjinisë *Agaricus* vetëm

në tokë, (livadhe e kullosa). Kërpudhat si: *Morchella esculenta*, *M. conica*, *Mitrophora semilibera*, *Verpa bohemica*, i kërkohet vetëm në muajt e pranverës (Mars- Maj).



Amanita virosa (kërpudha erëkeqe)-T

Albmed News: Na tregoni se si e bëni një determinim të tillë të kërpudhave?

Murati: Po ta shikojmë nga ana e poshtme e kapelës, në pjesën e quajtur himenium, ato mund të dallohen poqese kanë: fletëza, gyptha, gjilpërza ose ndonjë formë tjetër. Pastaj poqese konstatohet se posedon fletëza nën kapelë (*Agaricales*), atëherë menjëherë eliminohet një grup i madh i kërpudhave me gyptha (*Boletales*), si dhe ata me gjilpërza (*Hydnum*, *Sarcodon* etj. Më tutje e shikojmë këmbën, poqese konstatohet se në bazën e këmbës nuk ka vello të bardhë (çorapke), atëherë e kemi eliminuar një grup të kërpudhave helmuese që i përkasin gjinisë *Amanita*. Në vazhdim vështrohet kapela në pjesën e sipërme, a posedon lluspa ose është e lëmuar. Si hap tjetër në hulumtimin tonë paraqet prapë këmba e cila posedon ose jo unazë nën kapelë, pastaj a është unaza te këmba e lëvizshme apo jo? Poqese posedon unazë të lëvizshme atëherë janë të eliminuar të gjithë kërpudhat fletëzore me unazë të palëvizshme si dhe ato pa unazë. Si hap i fundit është të shikosh në fotografitë e librit dhe me mundësi që të gjejshë, identifikosh dhe dallosh, se për cilën kërpudhë bëhet fjalë, gjegjësisht kush është lloji i hulumtuar, pastaj me kujdes t'i lexoni të gjitha karakteristikat e përshkruara nën fotografi. Duke i përcjellur këto instruksione dhe të dhëna për kërpudhat besojmë se ja kemi arritur qëllimit, dhe shumë lehtë e kemi gjetur llojin e duhur. Në veçanti, është më mirë që të lexoni tekstin pranë fotografisë së kërpudhës, ku shkruan se kjo kërpudhe ka të njëjtat veti si kërpudha e gjetur. Do të jeni më se të kënaqur dhe të gëzuar se e kemi gjetur llojin e kërpudhës. Kuptohet se për numrin më të madh të tyre, duhet të përdoren çelsa (libra) për identifikimin dhe determinimin e tyre me qëllim që mos na japi ndonjë kahje tjetër dhe të gabojmë llojin e gjetur.

Albmed News: Profesor ju aktualisht jeni i angazhuar në Universitetin e Tetovës, por gjatë periudhës së kaluar ju keni bërë një punë të gjatë hulumtuese mbi kërpudhat dhe zhvillimin e tyre. Sa i kushtohet rëndësi hulumtimit të kësaj problematike në hapësirat shqiptare dhe në rrafshin global?

Murati: Jam i angazhuar si profesor i rregullt në USHT-Tetovë, në fakultetin e FSHMN-dega Biologji si dhe në fakultetin e posaformuar të FBB-Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë, ku ligjëroj: Mikrobiologji,

Botanikë dhe Biodiversitet. Përkaj mësimeve, punës me studentët, jam i angazhuar në punën shkencore nga lëmia e mikologjisë, biodiversitetit, ekologjisë dhe ekotoksikologjisë, ku punoj në koncentrimin e metaleve të rënda në kërpudha dhe substrate të tyre, që është një ndër problemet më aktuale mjedisore. Kësaj lëmie shkencore i kushtohet shumë pak rëndësi në trevat tona shqiptare. Jam autor-koautor i dhjetëra punimeve shkencore nga këto lëmi si dhe jam pjesëmarrës aktiv në konferenca shkencore. Poashtu së bashku me prof. Mitko Karadelev, një ndër mikologët më të njohur në Europë, jam i kyçur edhe në dy projekte: „Valorizimi i Biodiversitetit të Malit Sharr.“ dhe „Biodiversiteti i kërpudhave në Republikën e Kosovës“, sepse jam i vetmi mikolog në këto treva shqiptare. Gjithashtu jam pjesë e ekipit të ekspertëve për mikologji në Institutin e Ekologjisë dhe Teknologjisë “Scardus” pranë UT.



Omphalotus olearius (helmuese)

Albmed News: Të shpresojmë se kjo intervistë do t’u shërbejë të gjithë atyre që janë adhurues të denjë të bukurisë dhe shijes së kërpudhave si dhe atyre që bëjnë hapat e para të njohjes së kërpudhave. Profesor ju falënderojmë për shpjegimet e thukta që i prezentuat për lexuesit e portalit Albmed News.

Murati: Ju falënderoj për interesin e portalit tuaj dhe juve z. Shaban si adhurues i denjë të kërpudhave. Besoj që tash lexuesit do të kenë një pasqyrë krejt tjetër për kërpudhat.

Intervistoi: **Shaban Dalipi**